



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1291/1 prot.,

Datë 21.05.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME VLERËSIMIN ME PIKË
TË PROPOZIMEVE TEKNIKE PËR VETE

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK në procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence, (Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara)”, me Nr. REF-98559-03-18-2024, me objekt “Studim Projekttime në Programin e Shërbimeve Publike Vendore” me fond limit: 159,159,332 (njëqind e pesëdhjetë e nëntëmilion e njëqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në: 1,537,028.7 Euro,* Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.03.2024 është 103.55 Lekë/Euro, zhvilluar në datën 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, me NIPT K72113010E, dhe me adresë: Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr. 23, Z.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia e Tiranës
Adresa: Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001.

Në datën 21.05.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5328 dhe me nr. 1291/2025 prot, datë 21.05.2025 e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence, (Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara)”, me Nr. REF-98559-03-18-2024, me objekt “Studim Projekttime në Programin e Shërbimeve Publike Vendore” me fond limit: 159,159,332 (njëqind e pesëdhjetë e

nëntëmilion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në: 1,537,028.7 Euro,*
Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.03.2024 është 103.55 Lekë/Euro, zhvilluar në datën 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK.

Bazuar në nenin 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriterin e vlerësimit, arsyen e skualifikimit dhe objektin e pretendimeve që operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, parashtron në ankesën me nr. 1291/2025 prot., datë 21.05.2025.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto:

Çmimi X pikët 20

dhe

Propozimi teknik pikët 80

Kriteret e Vlerësimit teknik

Pikët

- | | | |
|-------|---|----------------|
| (i) | Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit | [1-10] |
| (ii) | Metodologjia e Propozuar | [20-30] |
| | (Përfaqsjë teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative) | |
| (iii) | Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar | [20-60] |
| (iv) | Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) | [nuk kërkohet] |

Shënim: pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri (iv), do t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Arsyet e skualifikimit:

Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” SHPK ka cituar në formular ankese që: *“Pretendojmë që vlerësimi nuk është bërë në mënyre korrekte pasi shoqëria jonë ka përmbushur të gjitha kërkesat dhe kushtet e vendosura në DST dhe ftesë nga AK. Ne si shoqëri kemi një eksperiencë shumëvjeçare në projekte, një staf të kualifikuar dhe me eksperiencë në këtë fushë. Mendojmë që jemi diskriminuar në mënyrën e vlerësimit të kësaj procedure”*.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 21.05.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini
Kryetar			
Jonaid Myzyri			